REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT

DREJTORATI I INSPEKSIONIT

Datë :	**03.11.2023**
Referencë	**11-344/10**
Për :	**Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës**
Kopje: **Kopje:**	**Diamant Bytyqi-Nënkryetar i Komunës** **Lulëzim Qerimi-Nënkryetar i Komunës**
Nga:	**Flamur Sylejmani-Drejtori i Inspekcionit**
Lënda :	**Raporti i muajit-tetor**

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Drejtoria e Inspektoratit në muajin tetor ka realizuar inspektime të ndryshme në kuadër të kompetencës, duke përfshirë të gjitha lokalitetet.

Inspektorët e tregut- objektivë e inspektimit gjatë këtij muaji nga inspektoret e tregut ka qenë: inspektimi i dyqaneve të cilat merren me shitjen e auto-pjesëve, gjatë inspektimit nga bizneset është kërkuar regjistrimi i biznesit, pranimi teknik, ekspozimi i çmimeve të shitjes dhe flamujve të origjinës për artikujt e ekspozuar për shitje, si dhe janë inspektuar markete dhe rrjetet e marketeve të cilat mirren me shitjen e duhanit dhe alkoolit lidhur me zbatimin e Ligjit nr.06/L034 për Mbrojtjen e Konsumatorit, neni 15 i cili ndalon shitjen, shërbimin dhe dhurimin e pijeve alkoolike dhe duhanit, personave nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare.
Është inspektuar për çmimin e artikujve, përputhshmërinë e çmimeve raft-arkë si dhe vendosjen e flamujve të cilët tregojnë origjinën e mallit.
Janë realizuar urdhëresa për pranime teknike të lokaleve afariste. Në bizneset të cilat kemi hasur parregullsi është iniciuar procedurë kundërvajtësve në Gjykatën Themelore në Prishtinë-dega Lipjan.
Gjatë muajit tetor është bërë inspektimi i tregjeve: tregut të gjelbër, kafshëve dhe mobileve. Janë realizu inspektime për të mos lejuar shitjen jashtë tregut.

Inspektori i mjedisit-ambientit- gjatë muajit tetor nga inspektori i mjedisit-ambientit përveç agjendës, me prioritet i është përgjigjur ankesave të qytetarëve si në: Magure, Grack e Vjetër, Lagjja e Re, Janjevë, Babush, Gadime, Sllovi, Shalë, Banullë dhe në qytet. Ankesat ishin të ndryshme: mbeturina të hedhura në pronën publike, natyrë, ndotje të ajrit shkaku i ndezjes së mbeturinave, mbyllje të rrjetit të kanalizimit, ankesa për kundërmim me pleh etj. Është shqyrtuar secili rast dhe me procesverbal janë dhënë urdhëresa për mënjanimin e parregullsive brenda një kohe të caktuar, janë shqiptuar edhe gjoba mandatore. Për rastet e mbylljes së rrjetit të kanalizimit është lajmëruar ujësjellësi KUR Prishtina dhe drejtorit përkatëse të Komunës.
Për dëmtim të pronës publike (gjelbërimit dhe trotuarit) gjatë kryerjes së punimeve në rrugën "Lidhja Prizreni" nga KEDS, është dhënë urdhëresë me procesverbal për rregullimin e hapësirës (e cila urdhëresë është zbatuar).
Janë inspektuar deponit ilegale të mbeturinave në fshatrat: Gllogovc, Gadime e Ulët, Kodrën e Kërçevës, Shalë, Leletiq te Currieli, Magure, Sllovi, Topliqan. Janë takuar persona duke hedhë mbeturina, janë gjetur edhe dëshmi për hedhjen e mbeturinave në natyrë. Janë inspektuar objektet ndërtimore me shumë njësi banimi dhe afarizëm të cilat janë duke u ndërtuar në Lipjan për zbatimin e kushteve të lejes mjedisore komunale, janë dhënë urdhëresa për grumbullimin e mbeturinave, vendosja e tyre në kontejner si dhe lidhja e kontratës për mbeturina me K. Pastrimi.

Inspektorët e trafikut- objektivë e inspektoreve të trafikut ishte veprimtaria e taksive ilegal dhe kombi taksi, ku janë konfiskuar targat si dhe janë marrur masa ndëshkimore sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.
Është organizuar aksion në bashkëpunim me Policin e Kosovës njësia në Lipjan në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" ku është bërë inspektim i auto-taksiv "Ulpiana".
Janë realizu pika kontrolli për të përcjell rendet e udhëtimit nga kompanitë e ndryshme të autobusëve, ku janë urdhëruar që të respektojnë rendin e udhëtimit të lëshuar nga organi kompetent.
Inspektim në Magure ku është urdhëruar një qytetar të largoj një penges (pa pëlqim) të vendosur në rrugë.

Inspektori i ndërtimit- gjatë këtij muaji inspektori i ndërtimit ka inspektuar në teren objektet të ndryshme ndërtimi përgjatë zonave urbane, ekonomike, industriale, si dhe janë realizu vizita inspektuese me kërkesë të ndërtuesve për fazat ndërtimore.
Janë realizuar dy rrënime të terasave të lokaleve afariste si dhe një kioskë është larguar në rrugën „Lidhja e Prizrenit"–Lipjan.
Nga inspektorët e ndërtimit janë realizu, procesverbale, fletëparaqitje, gjoba dhe vendosje të shiritave.

Drejtoria e Inspektoratit është përgjigjur në të gjitha ankesat e pranuara nga qytetarët.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë muajit tetor janë:

Inspektimi i dyqaneve të cilat merren me shitjen e auto-pjesëve.
Inspektimi i dyqaneve dhe marketeve të cilat mirren me shitjen e duhanit dhe alkoolit në lidhje me zbatimin Ligjit nr.06/L034 për Mbrojtjen e Konsumatorit.
Janë realizuar urdhëresa për pranime teknike të lokaleve afariste., si dhe janë bërë 9 pranime teknike te lokaleve afariste.
Ndalimi i tregtimit në rrugët e qytetit (ndalim i shitjes jashtë tregut).
Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.
Inspektimi-kontrollimi i firmave të autobusëve në qytet dhe fshatrat.
Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.
Inspektimi i auto-taksive në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Vrellë.
Fletëparaqitje për Kundërvajtje.
Shqiptimi i gjobave mandatore.
Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspektime	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje	Rrënime te ekzekutuara nga inspektorati	Pranim teknik me komision (projekte komunale)	Vendosje të shiritave	Vërejtje, njoftime	Punë me palë, ankesa , kërkesa	Lendet e pranuara	Lende te pezulluara, ekzekutuara gjygjesore	Konfiskim i targave, librezës dhe kthim	Gjoba mandatore	Te hyra nga pranime teknike	Inspektim i biznseve pa pranime teknike	Menaxhim i tregjeve	Aktvendime, ndalesa, urdhëresa	Inspektim me polici	Inspektim i biznseve pa regjistrim
Biznesi	190	31	9	1					70	26					9	12	29		3
Ambienti	38	8							12	10			5					3	
Ndërtimi	85	20			3	3	5	33	2	12			3				4		
Trafiku	69	12		1			23		12			4	2			10	2	3	
Gjithsej	382	71	9	2	3	3	28	33	96	48		4	10		9	22	35	6	3

DISKUTIMET PUBLIKE

Diskutime publike nuk kemi mbajtur.

TAKIME TË TJERA

Takimet janë mbajtur me pronar të bizneseve, pronar të ndërtimeve, me taksistë dhe qytetarë të tjerë.

SFIDAT

Inspektimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore.
Inspektimi i bizneseve të paregjistruara, pa pranime teknike.
Ndalimi i hedhjes së mbeturinave inerte në tokat bujqësore, mbrojtja e hapësirave gjelbëruese,
Inspektime të auto-taksive, firmave të autobusëve në qytet dhe në fshatra si dhe inspektimi i taksive ilegal në ANP.

REKOMANDIMET

Rekomandojmë qytetarët të cilët hasin në ndonjë parregullsi e cila trajtohet me kompetencë nga Inspektorati Komunal të na njoftojnë në Drejtorin e Inspektoratit.